



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:283771
Datë: 11.05.2021
Numri i dokumentit: 01770337

C.nr.1023/19

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Civil, Gjyqtari Malsor Kryeziu, me sekretaren juridike Drita Haxhishabani, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses M. Sh., nga Gjakova, rr.”. . .”, të cilën e përfaqëson i autorizuari Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës– Drejtoria e Arsimit, për kompensimin e ushqimit gjatë punës, vlera e kontestit 2.198.00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 26.04.2021, në prezencën e të autorizuarit të paditëses dhe në mungesë të të paditurës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses M. Sh., nga Gjakova dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqimin ditor – shujtën, për praninë në punë për periudhën kohore prej datës 01.01.2015 e deri me datë 29.02.2020, për ditët totale të pranisë në punë prej 1.057 ditë (dhe atë për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro) paditëses M. Sh., nga Gjakova, t’ia paguaje shumen totale prej 2,114,00 euro, me kamatë prej 8%, duke filluar nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, me datë 26.04.2020, e deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura që në emër të pagesës për shpenzimet e procedurës, paditëses t’ia paguaje shumen totale prej 269,20 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Seanca kryesore është mbajtur konform nenit 423.4 të LPK-së.

Paditësja në padi në këtë çështje juridike, nëpërmes të autorizuarit të lartpërmendur të saj, ka parashtruar se e njëjta është punësuar si mësime dhënëse e lëndës së gjuhës shqipe në Institucionin arsimorë “Hajdar Dushi” në Gjakovë, pranë Drejtorisë së Arsimit në Gjakovë. E paditura në bazë të nenit 36 të Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 11.04.2014 dhe në

bazë të nenit 35, par. 7 të Kontratës Kolektive, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 01.09.2014, i takojnë nga dy (2) euro ditë për çdo ditë të paraqitur në punë, në emër të ushqimit – shujtës, e të cilin obligim duhet të e kryejë e paditura e cila ka legjitimitet të plotë pasiv. E paditura edhe përkundër detyrimeve të cilat rrjedhin nga Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës dhe Kontrata Kolektive, nuk ka përmbushur obligimet e caktuara që rrjedhin nga të njëjtat, kështu që për këtë arsye paditësja ka qenë e detyruar që të parashtojë padi – kërkesëpadi dhe të kërkojë realizimin e të drejtës së saj subjektive.

Përmes parashtrësës së dt.18.02.2021 i autorizuari i paditësës ka bërë precizimin e kërkesëpadisë përmes së cilës ka kërkuar që të detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Arsimit në Gjakovë, që në emër të kompensimit të shpenzimeve për ushqimin ditor – shujtën, për praninë në punë për periudhën kohore prej dt.01.01.2015, e gjer më datë 29.02.2020, për ditët totale të pranisë në punë prej 1057 ditë (dhe atë për secilën ditë të pranisë në punë shumën nga 2 euro) paditësës M. Sh., t'ia paguaje shumën totale prej 2.114,00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përbarimit

I autorizuari i paditësës në seancën kryesore ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë padisë si dhe parashtrësës së datës 19.02.2021, i propozoj gjykatës që të administrohen provat e propozuara dhe i propozoj gjykatës që të aprovohet kërkesëpadia e precizuar. Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara nga kjo gjykatë në mënyrë të padyshimtë u vërtetua baza e padisë dhe lartësia e kërkesëpadisë ashtu që gjykatës i propozoj që të njëjtën ta aprovojë si të bazuar ashtu siç është precizuar me parashtrësën e dt.19.02.2021. Shpenzimet procedurale i kërkojmë dhe atë për taksë gjyqësore në shumën prej 40,00 euro, përpilimi i padisë në shumën prej 104,00 euro si dhe përfaqësimi në seancë 135,20 euro në shumën totale prej 279,20 euro.

E paditura në përgjigjen në padi të parashtruar pas afatit ligjor ka theksuar se e kundërshtojë në tërësi padinë dhe kërkesë padinë si të pa bazuar me arsyetimin se Komuna e Gjakovës nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që MASHT-i dhe SBASHK-u, nuk janë të angazhuar për ti informuar dhe ndihmuar Komunitat që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe kostos buxhetore për zbatimin e kësaj kontrate në Ministrinë e Financave me qëllim të realizimit të buxhetit etj.. dhe ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditësës ta refuzoj si të pa bazuar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: ka bërë leximin e kontratës së punës e lidhur nga paditësja M. Sh., me të paditurën Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komuna e Arsimit me dt.01.09.2017, vërtetimin e lëshuar nga Gjimnazi "Hajdar Dushi" në Gjakovë, nr.452, dt.18.02.2021.

Nga provat e administruara në mënyrë të gjithmbarshme, gjykata ka vërtetuar faktin se nuk është kontestuese se paditësja M. Sh., nga Gjakova, është e punësuar në marrëdhënie pune të përhershme tek e paditura në cilësinë e mësimdhënëses së lëndës së Gjuhës shqipe, e punësuar në Gjimnazin "Hajdar Dushi", në Gjakovë. E paditura nuk e ka kontestuar vijueshmërinë e paditësës në punë, po ashtu nuk i ka kontestuar edhe ditët e pranisë në punë të paditësës. Pavarësisht se e paditura nuk i ka kontestuar, gjykata ka vlerësuar veç e veç provat e prezantuara nga pala paditëse, nga të cilat vërtetohet se paditësja M. Sh., nga Gjakova, është në marrëdhënie pune të përhershme tek e paditura, e punësuar në Gjimnazin "Hajdar Dushi", në Gjakovë, në cilësinë e mësimdhënëses së lëndës së Gjuhës Shqipe.

Nga Vërtetimi nr.452, i dt.18.02.2021, i lëshuar nga Gjimmnazi "Hajdar Dushi" në Gjakovë,, për paditësen M. Sh., vërtetohet se paditësja për vitin shkollor për vitin 2014/2015, përkatësisht prej datës 01.01.2015 deri në përfundim të viti shkollor ka vijuar punën për 141 ditë të pranisë në punë, për vitin 2015/2016, ka vijuar punën për 226 ditë, për vitin 2016/2017, ka vijuar punën për 223 ditë, për vitin 2017/2018, ka vijuar punën për 118 ditë, për vitin 2018/2019, ka vijuar punën për 224 ditë, për vitin 2019/2020, deri me dt.29.02.2020 ka vijuar punën për 125 ditë, gjithsej 1057 ditë të pranisë në punë.

Andaj, gjykata në rastin konkret vërteton se në bazë të nenit 36 të Kontratës Kolektive të Arsimit Para universitar, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe SBASHK, me datë 11.04.2014 si dhe në bazë të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të dt.18.04.2017, sipas të cilës dispozitë ligjore në mënyrë decidive është paraparë se: *"Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t'a bërë kompensimin"*, ashtu që në rastin konkret gjatë gjithë procedurës provuese e paditura nuk ka argumentuar (me asnjë provë materiale dhe as me përgjigje në padi të ushtruar pas aftit ligjor), faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve (në vend punimin – objektin ku ka punuar këtu pala aktive në procedurë), nga ana tjetër duke pasur parasysh faktin se nga vërtetimi i lartcituar, për periudhën kohore të kërkuar nga pala aktive në procedurë, rezulton se paditësja, ka punuar në vendin e caktuar të punës për 1057 ditë pune, andaj ka kërkuar që kompensimi të i bëhet për 1057 ditë pune (siç është saktësuar në precizimin e kërkesës), ashtu që gjykata paditëses, për këto ditë pune të kërkuara (nga 1057 ditë punë x 2€ në ditë), rezulton se kërkesëpadia e saj e precizuar në lartësi prej 2.114,00€, është e bazuar dhe si të tillë e gjykata e aprovojë si të bazuar.

Gjykata vlerëson se Kontratat Kolektive të Arsimit në Kosovë ka qenë, respektivisht, është në fuqi dhe e zbatueshme në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe se ky dokument kontraktual, prodhon efekt juridik ndaj palëve në procedurë të cilat janë të legjitimuara në kuptimin e legjitimitetit real aktiv dhe pasiv në këtë çështje juridike.

Sipas nenit 8 par. 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L – 077), i publikuar në "Gazetën Zyrtare" të Republikës së Kosovës, nr. 16/2012, datë 19.06.2012 (i cili është në implementim nga data 20.12.2012, është paraparë se: *"Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij"*. Për më tepër dispozita e nenit 245 par. 1 të LMD-së, ka paraparë se: *"Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij"*. prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura në rastin konkret është e detyruar që kreditori, përkatësisht këtu paditëses në rastin konkret, të ia paguajë vlerën e precizuar të kërkesëpadisë si dhe shpenzimet tjera aksesore, siç më detalisht është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 452 par. 1 të LPK-së.

Prandaj, gjykata, bazuar ne arsyet e cekura me larte, bazuar ne nenin 143 paragrafi 1 te LPK-së, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
C.nr.1023/19, datë 26.04.2021

GJYQ TARI
Malsor Kryeziu

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar Ankesa në afatin prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.